



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT ¹

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Datë: 13.12.2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “**SI.SI-AL sh.p.k**” sh.p.k, me NUIS K72117030P, me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04197-08-31-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”, me afat lëvrimi 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës, me fond limit 13.467.500 (trembëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 132, datë 07.09.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “**VILA DEKOR**” sh.p.k, me NUIS L41329006M, me adresë: Njësia Nr. 11, Kthesa e Kamzes,Pallati Alba Konstruksion, Nr. Pasurie 60/88-N7, Tiranë dhe me ofertë ekonomike **8.478.000** (tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh.
2. “**DEUTHCOLOR**” sh.a, me NUIS L21326504J, me adresë: Durres Maminas VLASHAJ Autostrada Tiranë - Durrës,Zonë Kadastrale 3796 dhe me ofertë

¹ Ky Formular eshte i aplikueshem nese ka Ankime

ekonomike **8.747.300** (tetë milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e treqind) lekë pa tvsh.

3. **“SI.SI-AL sh.p.k”** sh.p.k, me NUIS K72117030P, me adresë: Kashar Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se dhe me ofertë ekonomike **9.710.000** (nëntë milion e shtatëqind e dhjetë mijë) lekë pa tvsh.
4. **“GENTIAN HORJETI”** p.f, me NUIS K31427013J, me adresë: rruga “5 Maji”, ish NPK, Tiranë dhe me ofertë ekonomike **9.900.700** (nëntë milion e nëntëqind mijë e shtatëqind) lekë pa tvsh.
5. **“VALONA KONSTRUKSION”** sh.p.k, me NUIS K26330202E, me adresë: Lagjja Uji i Ftohte, ne perendim te Rruges Vlore-Orikum, ne kufi me rezidencen Rezidencen Qeveritare, Vlorë dhe me ofertë ekonomike **10.872.000** (dhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh.
6. **“Sings & Road Safety Solutions”** sh.p.k, me NUIS L62228020U, me adresë: rruga “Panorama”, Tiranë dhe me ofertë ekonomike **11.367.880** (njëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.
7. **“ERAL CONSTRUCTION COMPANY”** sh.p.k, me NUIS K82230002K, me adresë: Rruga Tepelene Progonat,Vendndodhja Skaranë, ngastra nr.80d,Kod kadastral Gj 3400080d rl,zk 1149, Tepelenë dhe me ofertë ekonomike **13.384.375** (trembëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.
8. **“ELDA-VL”** sh.p.k, me NUIS K67106202W, me adresë: Lagjja 10 korriku, Rruga Pelivan Leskaj, Sheshi i Zhvillimit ne Truallin me Nr.Pasurie 19/223, Zona Kadastrale Nr.8602 Vlore dhe me ofertë ekonomike **0** (zero) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“VILA DEKOR”** sh.p.k, me NUIS L41329006M
2. **“DEUTHCOLOR”** sh.a, me NUIS L21326504J
3. **“GENTIAN HORJETI”** p.f, me NUIS K31427013J
4. **“VALONA KONSTRUKSION”** sh.p.k, me NUIS K26330202E
5. **“ERAL CONSTRUCTION COMPANY”** sh.p.k, me NUIS K82230002K
6. **“ELDA-VL”** sh.p.k, me NUIS K67106202W,

Për arsyet e mëposhtme:

“VILA DEKOR” sh.p.k

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 6) në ambalazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka konstatuar se Operatori Ekonomik ka paraqitur mostra të pavlefshme për zërat bojë bikomponente spray (ngjyrë e bardhë, e verdhë dhe e zezë), bojë bikomponente paste (ngjyrë e bardhë, e kuqe, e verdhë, e zezë, jeshile, blu, portokalli dhe lejla) dhe bojë akrilike (ngjyrë e verdhë dhe e zezë). Mostrat e të gjitha bojërave të sipërpërmendura nuk kanë të stampuar në trup datën e prodhimit dhe/ose skadencës së tyre në kundërshtim me atë çka është parashikuar në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumentave standarte të tenderit, ku konkretisht kërkohet që në trupin e kovës duhet të shënohet data e prodhimit dhe/ose skadencës së saj.

“DEUTHCOLOR” sh.a

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 6) në ambalazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka konstatuar se Operatori Ekonomik ka paraqitur mostra të pavlefshme ditën e tenderit, përkatësisht në datë 16.09.2021 për zërat bojë bikomponente spray (ngjyrë e bardhë, e verdhë dhe e zezë), bojë bikomponente paste (ngjyrë e bardhë, e kuqe, e verdhë, e zezë, jeshile, blu, portokalli dhe lejla) dhe bojë akrilike (ngjyrë e zezë). Mostrat e të gjitha bojërave të sipërpërmendura janë të skaduara pasi data e skadencës e stampuar në trupin e tyre është 13.05.2021.

“GENTIAN HORJETI” p.f

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 6) në ambalazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.”*

Mostrat e paraqitura për zërin fosfor 125-600; fosfor 125-850 dhe fosfor 125-1180 janë të ndryshme nga produkti që paraqet skeda teknike e ngarkuar në sistemin SPE nga operatori ekonomik.

“VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 6) në ambalazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka konstatuar se Operatori Ekonomik ka paraqitur mostra të pavlefshme ditën e tenderit, përkatësisht në datë 16.09.2021 për zërat bojë bikomponente spray (ngjyrë e bardhë, e verdhë dhe e zezë), bojë bikomponente paste (ngjyrë e bardhë, e kuqe, e verdhë, e zezë, jeshile, blu, portokalli dhe lejla) dhe bojë akrilike (ngjyrë e verdhë). Mostrat e të gjitha bojërave të sipërpërmendura janë të skaduara pasi data e skadencës e stampuar në trupin e tyre është 13.05.2021.

“ERAL CONSTRUCTION COMPANY” sh.p.k

1. OE nuk përmbush pikën 1, shkronja b, të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se "*Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:...b. Sigurimin e ofertës, sipas Shtojcës 3...*" pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.
2. Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.
3. Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin dhe diluentin, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.
4. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 6) në ambalazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim"* pasi nuk është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar ne DST.
5. Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: "*Operatori ekonomik duhet të deklarojë se malli objekt prokurimi do të jetë i prodhuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e lëvrimit të mallit pranë AK. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.
6. Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallin objekt prokurimi, për një periudhë jo më pak se 1 (një) vit nga data e lëvrimit të mallit pranë AK. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

“ELDA-VL” sh.p.k, me NUIS K67106202W,

Operatori ekonomik “ELDA-VL” sh.p.k nuk kualifikohet pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “SI.SI-AL sh.p.k” sh.p.k me NUIS K72117030P, me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se,

Kashar, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **9.710.000** (nëntë milion e shtatëqind e dhjetë mijë) lekë pa tvsh është **identifikuar si Oferte e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga “5 Maji”, Tiranë, tek Personi Përgjegjës për procedurën e prokurimit, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **11.367.880** (njëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Po

Vendim përfundimtar i KPP-së Nr.986/2021, datë 10.12.2021